



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:120053

Datë: 13.09.2021

Numri i dokumentit: 02168025

P.nr.426/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtaritë të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit A. I. nga Gjilani për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 2 i KPRK-ës duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr....-a/2021, të datës 11.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 01.09.2021 dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit mori dhe publikisht ndërsa me datë 13.09.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri A. I. nga babai S.t dhe nëna H., e lindur P., i lindur me datë ..... në fshatin T., Komuna e K. ndërsa me vendbanim në Gjilan, rruga “.....” pa numër, i martuar, baba i ..fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 07.05.2021 rreth orës 20:05 minuta në kafiterinë “....” në Gjilan me pronar Q.G., i pandehuri i cili ishte në gjendje të dehur, fillimisht fjaloset me të dëmtuarin e më pastaj e kanos me fjalët duke i thënë “kam ardhur për ta ndezur shtëpinë, ku do të thërras vëllain tim për këtë dhe e kam revolen me vete, që për atë kam ardhur këtu dhe asnjë nuk guxon të lëvizni”, e ku i pandehuri e nxjerrë atë lodër-revole e të cilin i dëmtuari ia kishte larguar nga dora, me çka tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës, ankthit dhe pasigurisë për vetën e tij.

-Me çka ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurin e lartcekur:

### E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Megenëse i dëmtuari në seancën e datës 15.07.2021 ka deklaruar se në këtë çështje penale juridike nuk paraqet kërkesë pasurore juridike rrjedhimisht edhe gjykata nuk vendosi për kërkesën pasurore juridike.

Në bazë të nenit 92 të KPRK-ës nga i pandehuri i lartcekur KONFISOHET:

- a) 1 (një) revole lodër dhe
- b) 1 (një) brisk me ngjyrë të zezë.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### ARSYETIM

#### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 15.06.2021 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.../2021 kundër të pandehurit Arben Ismajli nga Gjilani për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 2 i KPRK-ës.

Me datë 01.09.2021 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezente prokurori i shtetit dhe i pandehuri, me ç'rast pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e kishte kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njejtë kishte deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

## 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë raporti me numër ta rastit 2021-CA-.....i datës 07.05.2021, raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-CA-..... i datës 07.05.2021, deklarata e të pandehurit, deklarata e dëshmitarit, deklarata e dëmtuarit, raporti i policit, testit i alkoolit i datës 07.05.2021 ku konstatohet se i pandehuri ishte nën ndikimin e alkoolit me 1,76 promil, dëftesa mbi konfiskimin e pronës, raporti i oficerit, formular i pronë dëshmie, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu gjykata me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri Arben Ismajli ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 2 i KPRK-ës si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit, pranimin e fajësisë nga i pandehurit, rrethanat personale të tij si dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në

barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, ka kërkuar falje për këto veprime dhe ka shtuar se më të dëmtuarin pas këtij rasti nuk kanë pasur probleme se me të njëjtin i kanë rregulluar raportet, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori faktin se nga veprimet e tij tek i dëmtuari në vendin e tij të punës është shkaktuar frikë dhe shqetësim i madh emocional përfshirë edhe personat e tjerë që kanë qenë prezent në kafiterinë e të dëmtuarit andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 72 të KPRK-ës gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

I dëmtuari Q.G. në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 15.07.2021 ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike në këtë çështje penalo juridike dhe rrjedhimisht gjykata nuk vendosi për të.

#### 6. Vendimi për konfiskimin

Pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës gjykata gjeti se propozimi i prokurorit të shtetit për konfiskimin e sendeve të cekura si në aktakuzë është i bazuar për faktin se të njëjtat janë sende të cilat kanë mundësuar kryerjen e veprës penale nga ana e të pandehurit dhe rrjedhimisht nga i pandehuri konfiskoi 1 (një) revole lodër si mjet i kryerjes së veprës penale dhe 1 (një) brisk me ngjyrë të zezë e cila i është gjetur të pandehurit me rastin e kontrollit nga ana e zyrtarëve i cili brisk në bazë të nenit 282 të KPP-ës automatikisht i nënshtrohet konfiskimit.

#### 7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.426/2021 me datë 13.09.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.